

PROJEKTREZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2018

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur dhe vlerësuar rolin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në grumbullimin, administrimin, ruajtjen dhe dokumentimin e materialeve të kësaj periudhe në Shqipëri;

Duke njohur bashkëpunimin e këtij Instituti me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera vendase e të huaja për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit;

Duke konsideruar se detyrat kryesore të punës së këtij instituti kërkojnë mbështetjen e vazhdueshme të organeve shtetërore, medias, shoqërisë civile dhe partnerëve, në funksion të ruajtjes së kujtesës tonë kolektive;

Duke konstatuar nevojën për ndryshime ligjore në lidhje me qëllimin, objektin dhe përcaktimin e saktë të “periudhës së sistemit komunist”, miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit nga Kuvendi, në mbështetje të mbarëvajtjes së punës së Institutit;

Vlerëson veprimtarinë e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit gjatë vitit 2018 në drejtim të:

- Konsolidimit të aktivitetit nëpërmjet projekteve informuese dhe botimit, promovimit dhe shpërndarjes të librave të rinj ku përfshihen studime shkencore, albume, botime dokumentuese, memuare, letërsi publicistike, botime historike si dhe fjalori enciklopedik i viktimave të terrorit komunist.
- Organizimit të një serie leksionesh dhe bisedash me karakter informues dhe sensibilizues mbi dramën e komunizmit dhe pasojat në realitetin e sotëm, me nxënësit e shkollave të të gjitha niveleve të arsimit publik dhe jopublik.
- Krijimit të arkivës audio-vizuale të dëshmimeve të ish të përndjekurve politikë me qëllim evidentimin e krimeve të komunizmit përmes rrëfimit të të mbijetuarve, si dhe krijimit të një arkive materiale me artifakte dhe çdo gjurmë tjetër të trashëgimisë materiale komuniste.
- Përpunimit të dokumenteve elektronike dhe realizimit të video-regjistrimeve me dëshmi të të mbijetuarve nga burgjet dhe kampet e regjimit komunist.

- Realizimit të filmit të parë dokumentar në 3D “Kampi i Tepelenës”, në kuadër të projekteve informuese-sensibilizuese, i cili i paraprin ciklit të muzeve virtuale të burgjeve dhe kampeve në Shqipërinë komuniste.

- Zgjerimit të bashkëpunimit me institucionet vendase, si dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, ku veçojmë pranimin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri si anëtar në rrjetin ndërkombëtar të institucioneve të kujtesës.

Kuvendi rekomandon që Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, për vitin 2019, të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Të vijojë studimin, evidentimin dhe sensibilizimin e publikut ndaj trashëgimisë materiale e cila dëshmon drejtpërsëdrejti krimet e sistemit komunist si: ish burgjet, kampet e punës së detyruar dhe kampet e internimit.
- Të vijojë publikimin e veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist.
- Të studiojë mekanizmat që u përdorën nga organet shtetërore dhe partiake për të krijuar hendekun ndërmjet kundërshtarëve politikë realë apo potencialë me pjesën tjetër të popullsisë.
- Të hulumtojë mbi format e rezistencës morale dhe kulturore nëpër burgje apo kampe përqendrimi si dhe shtypjen e ndëshkimit që i pasoi.
- Të evidentojë rolin që media dhe gazetaria shqiptare kanë patur gjatë periudhës postkomuniste, në nxitjen e ndjeshmërisë publike dhe reflektimin shoqëror ndaj të kaluarës së vendit.
- Të bashkëpunojë me televizionet kombëtare, për të ekspozuar punën studimore të Institutit, duke krijuar një hapësirë të dedikuar televizive me qëllim informimin publik mbi të shkuarën komuniste të vendit.
- Të forcojë aksesin publik online mbi të gjithë veprimtarinë e Institutit, të intensifikojë fushatat e ndërgjegjësimit duke përdorur gjerësisht rrjetet sociale, lehtësisht të arritshme, sidomos në brezat e periudhës post '90.
- Përmes forcimit të kapaciteteve shkencore dhe studimore të punonjësve të tij Instituti të rrisë standardet e botimeve dhe studimeve duke shmangur interpretimet e njëanshme të ngjarjeve dhe fakteve historike.

- Të propozojë ndryshimet e duhura ligjore të cilat sjellin përmirësimin e punës në Arkivin e Institutit, në përcaktimin e detyrimit ligjor për pajisjen me “certifikatë sigurie” për punonjësit që punojnë me dokumentet arkivore brenda dhe jashtë tij, me përcaktimin e qartë ligjor të “periudhës së sistemit komunist” në Shqipëri, si dhe me specifikimet që lidhen me kualifikimet shkencore të domosdoshme (tituj dhe grada shkencore), që duhet të kenë punonjësit e Institutit që merren me studime dhe botime.